



Република Северна Македонија

Министерство за одбрана

Konferencë gjashtëmuajore për periudhën janar-qershor 2023

Lidhja: Zbatimi i planit të dytë kombëtar të veprimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara "Gratë, Paqja dhe Siguria" (2020 - 2025) - kornizë strategjike

I. SHKALLA E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE NË PERIUDHËN JANAR – KORRIK 2023

Bazuar në aktivitetet e parashikuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të dytë kombëtar të veprimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara "Gratë, paqja dhe siguria" (2020 - 2025) - kornizë strategjike, në në periudhën janar-korrik 2023 janë realizuar këto aktivitete:

MINISTRIA E MBROJTJES

Në kuadër të qëllimit strategjik 1 - Liderhipi, i cili i referohet transparencës në përzgjedhjen, mbajtjen dhe avancimin e pozitave drejtuese, duke respektuar parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, u mbajt paneli i parë rajonal i liderëve kryesorë nga Ballkani Perëndimor organizuar në qershor në Beograd, Serbi nga UNDP/SEESAC. E nejtja mundësoi shkëmbimin rajonal të njohurive dhe shkëmbimin e informacionit mbi progresin me axhendën e barazisë gjinore në ministritë e mbrojtjes dhe të forcave të armatosura në Ballkanin Perëndimor. Ky panel diskutim rajonal bazohet në diskutimet dhe iniciativat nga takimi i parë rajonal i këshilltarëve dhe koordinatorëve gjinorë të mbajtur në mars 2023 në Budva dhe rezultatet e arritura që nga viti 2012 kur projekti u iniciua në partneritet me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Panel diskutimi rajonal përfshinte njëmbëdhjetë përfaqësues nga vendet e përmendura, veçanërisht liderët që kanë përfunduar Programin e Trajnimit Gjinor (Gender Couch Program), si dhe këshilltarë dhe koordinatorë gjinorë në ministritë e mbrojtjes dhe forcat e armatosura në Ballkanin Perëndimor. Në këtë aktivitet morën pjesë dy përfaqësues nga MM.

Në kuadër të qëllimit strategjik 2 – Përfshirja, e cila i referohet transparencës dhe përfshirjes në shoqëri, duke respektuar parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe

burrat, takimi i parë rajonal i këshilltarëve gjinorë dhe koordinatorëve gjinorë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Ballkanit Perëndimor u mbajt në mars në Budva të Malit të Zi. Ky takim kishte për qëllim shkëmbimin e njohurive dhe shkëmbimin e informacionit për barazinë gjinore në nivel rajonal, duke theksuar rolin e këshilltarëve gjinorë dhe koordinatorëve gjinorë në zbatimin e Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë. Morën pjesë Eprori për barazi gjinore në kabinetin e ShShP së Armatës dhe Koordinatori i GP për zbatimin e perspektivës gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatë.

Në kuadër të objektivit strategjik 3 – Lehtësimi, i cili i referohet kushteve të qëndrueshme dhe efektive në mbështetje të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, veçojmë aktivitetin e mëposhtëm:

Sipas Marrëveshjes së nënshkruar, nga viti i kaluar, për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe DCAF, në vitin 2023. filloi me zbatimin e procesit të vetëvlerësimit gjinor në MM dhe Armatë. Vetëvlerësimi gjinor është në formën e intervistave dhe fokus grupeve të destinuara për strukturat e mesme dhe të larta drejtuese nga MM dhe Armata, me ekspertë të jashtëm të angazhuar nga DCAF dhe për të mbështetur të njëjtat në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes u krijua grupi i punës.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes mjeteve-intervista dhe fokus grupe ka filluar dhe do të vijojë me shpërndarjen e një anketimi-pyetësi për vetëvlerësimin gjinor për një numër më të madh personash në MM dhe Armatë. Finalizimi i procesit, pra analiza e të dhënave, planifikohet të përfundojë deri në nëntor 2023, kur do të nisë përgatitja e Planit të Veprimit Gjinor me rekomandime dhe aktivitete specifike për MM dhe Armatë, e cila do të jetë në drejtim të përmirësimit të perspektivës gjinore në MM dhe Armatë.

Në kuadër të qëllimit strategjik 5 - Komunikimi, edukimi dhe trajnimi - Komunikimi efektiv dhe gjithëpërfshirës, edukimi dhe trajnimi për axhendën "Gratë, paqja dhe siguria", u regjistruan këto aktivitete të rëndësishme:

- Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vetëdija gjinore vazhdimisht forcohet me trajnime gjinore për personelin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatën, për këtë qëllim, në muajin mars u mbajt një seminar për zytarët administrativë dhe personelin ushtarak të MM me temë: "Perspektiva gjinore dhe PNJ-ja e dytë e rezolutës 1325". Seminari u mbajt në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes - Qendrën e Stërvitjes "Dr. Josef Kruzell", u zhvillua nga trajnerë të certifikuar gjinor nga Ministria e Mbrojtjes dhe Armata.

Gjithsej pjesëmarrësit në të dy periudhat e trajnimit ishin 32 (tridhjetë e dy), nga të cilët 25 (njëzet e pesë) ose 78% ishin gra dhe 7 (shtatë) ose 22% ishin burra.

Seminari kontribuoi që pjesëmarrësit të kuptojnë më në detaje rolet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në shoqëri, për të përvetësuar njohuri në fushën e barazisë gjinore, gjegjësisht rritjen e ndërgjegjësimit gjinor, si dhe për t'u njohur me proceset e integritit të perspektivave gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe njohja dhe ndërgjegjësimi në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga ngacmimet.

-Në drejtim të forcimit dhe ruajtjes së bashkëpunimit rajonal, i organizuar nga UNDP/SEESAC, u mbajt në maj në Vrsac të Serbisë takimi i shtatë rajonal i trajnerëve të certifikuar gjinorë nga

Ballkani Perëndimor. Takimi rajonal kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave, mësimëve të nxjerra dhe shkëmbimin e praktikave të mira për realizimin e trajnimeve gjinore, dhe në të njëjtën kohë u përcaktua versioni përfundimtar i trajnimit on-line për barazinë gjinore dhe perspektivën gjinore, zhvilluar në 3 module, të destinuara për personelin e ministrive të mbrojtjes dhe forcave të armatosura të Ballkanit Perëndimor. Morën pjesë 5 përfaqësues nga MM dhe Armata të cilët janë trajnerë të certifikuar gjinor.

Në muajin maj në QS "Dr. Jozef Kruzell" në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua një takim koordinues me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse dhe Grupit të Punës për Koordinim, Monitorim dhe Vlerësim (GP për KMDheV) për zbatimin e Planit të dytë Nacional të Veprimit (PNV) të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Rezolutës së OKB 1325 "Gratë, paqja dhe siguria", kuadri strategjik 2020-2025. Qëllimi i takimit ishte përmbledhja e punës së mëparshme, sfidat dhe rekomandimet, procesi i përgatitjes dhe dorëzimit të Raportit Vjetor për realizimin e aktiviteteve nga planet operative për zbatimin e PNV-së së dytë dhe aktivitetet e mëtutjeshme. Në muajin maj në QS "Dr. Jozef Kruzell" u mbajt një takim pune me trajnerët gjinorë të certifikuar nga MM dhe Armata, i cili kishte për qëllim:

- informacion për aktivitetet dhe projektet aktuale që zbatohen në Ministri dhe Armatë, informacion për shkallën e realizimit të PNV-së së dytë për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, paqja dhe siguria" (2020-2025) kuadri strategjik, koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve dhe trajnimeve të ardhshme në fushën e barazisë gjinore, diskutimi për përmirësimin e planifikimit, organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve gjinore në Ministri dhe Armatë. Takimi u përdor për shkëmbimin e përvojave, përmes prezantimit të mësimëve të nxjerra dhe informacionit ndërmjet trajnerëve të certifikuar gjinorë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Armata.

- Dy përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes (koordinatori dhe zëvendëskoordinatori për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në Ministrinë e Mbrojtjes) përfunduan me sukses "Trajnimin e trajnerëve për buxhetim të përgjegjshëm gjinor" i cili zhvillohet në Qendrën burimore për çështjet gjinore, politikëbërje dhe buxhetim i përgjegjshëm, në periudhën 30 maj - 1 qershor 2023, me ftesë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

- Gjatë muajit qershor 2023, në hapësirat komunale të Kumanovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, është mbajtur trajnimi gjinor me titull "Gratë dhe siguria - Ngritja e vetëdijes gjinore" për stafin, gjegjësisht stafin e SIBRIG (SEEBRIG-South-Eastern Europe Brigade).

Trajnimi kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të personelit nga shtabi i SIBRIG-ut për perspektivën gjinore dhe rëndësinë e integritit gjinor në operacionet e mbështetjes së paqes, por edhe për të forcuar aftësitë, kapacitetet dhe kompetencat e veçanta të personelit të përfshirë drejtpërdrejt në proceset ushtarake në nivelin shumëpalësh.

Trajnimi u krye nga një ekip rajonal mobil trajnues i përbërë nga trajnerë të certifikuar gjinorë nga Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi, organizuar dhe mbështetur nga Rakviak-Qendra për Bashkëpunim në Siguri, Kroaci. Drejtor i trajnimit ishte trajner i certifikuar për çështjet gjinore nga Ministria e Mbrojtjes.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Objektivi strategjik 4 - Mbrojtja – sigurimi i mbrojtjes efektive dhe gjithëpërfshirëse të burrave dhe grave, objektivi strategjik specifik 4.1: Krijimi i shërbimeve për përmirësimin e mbrojtjes së viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje: Afati për realizimin e aktivitetit sipas këtij qëllimi strategjik ka kaluar (korniza kohore 2020-2023) dhe janë kryer të gjitha aktivitetet përgatitore të përshkruara në raportet e mëparshme.

Shënim: Realizimi i këtij qëllimi strategjik dhe aktivitetet e planifikuara do të bëhen në vazhdimësi dhe në kuadër të mundësive buxhetore dhe prioritetive të përcaktuara të MPB.

- Objektivi specifik strategjik 4.2: Parandalimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- U zhvillua trajnimi në kuadër të projektit: "Edukimi i programit për dhunën me bazë gjinore ndaj grave". Këtë trajnim e kanë kryer gjithsej 4 punonjës policie, nga të cilët 1 burrë dhe 3 gra.

- U zhvillua trajnimi me temë: "Intervistim i avancuar i viktimave të dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim". Këtë trajnim e kanë kryer gjithsej 6 punonjës policie, 4 prej të cilëve meshkuj dhe 2 femra.

- Objektivi specifik strategjik 4.3: Rritja e transparencës në drejtim të parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe në familje:

- Në periudhën raportuese përfaqësues nga MPB nga njësitë organizative: NjSPSKC, DPK, SPB „Shkup“ dhe Qendra e Trajnimit mori pjesë në trajnimin e trajnerëve për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje. Organizuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

- Gjatë periudhës raportuese, përfaqësuesi i MPB-së ka marrë pjesë në takimin punues të organit multisektorial kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Strumicë, ku temë e diskutimit ishte nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal dhe protokollat për bashkëpunim ndërsektorial.

- Në web-faqen e MPB është publikuar raporti vjetor për vitin 2022 i organeve të administratës shtetërore për ecurinë e gjendjes së mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, nr.08-34693/1, datë 29.03.2023.

- Në web-faqen e MPB është publikuar Raporti i Ministrisë së Brendshme për Buxhetin e Përgjegjshëm Gjikor për vitin 2022, nr.08-28793, datë 14.03.2023.

- Në web-faqen e MPB është publikuar Strategjia për Barazi Gjinore 2022-2027.

- Objektivi strategjik 5 - Komunikimi, edukimi dhe trajnimi - Komunikimi efektiv dhe gjithëpërfshirës, edukimi dhe trajnimi mbi axhendën "Gratë, paqja dhe siguria", një objektivi specifik strategjik 5.2: Forcimi i kapaciteteve të personelit të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e

PNV-së së Dytë për Rezolutën 1325 të OKB-së, Gratë, Paqja dhe Siguria:

- Në organizim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, është mbajtur takim koordinues me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse dhe Grupi punues për koordinim, monitorim dhe vlerësim për zbatimin e PNV-së së Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Rezolutës së OKB-së 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" kuadri strategjik 2020-2025.

Të tjera

- Gjatë periudhës raportuese, përfaqësues nga MPB morën pjesë në gjithsej tri tryeza të rrumbullakëta me temën: "Zbatimi i zgjidhjeve ligjore për problemin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial", organizuar nga Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore - KKBGJ

- për të nxjerrë përfundime dhe për të dhënë rekomandime për bashkëpunim ndërsektorial, si dhe për përmirësimin dhe avancimin e mbrojtjes së viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Në kuadër të objektivit strategjik 2-Përfshirja, objektivi strategjik specifik 2.1-përmirësimi i kornizës normative për mundësi të barabarta dhe kushte për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (BPGJ):

Në kuadër të projektit "Përparimi i institucionalizimit të BPGJ-së përmes integritit sistematik të perspektivës gjinore në planifikimin strategjik dhe programimin e institucioneve qeveritare në Maqedoninë e Veriut", janë organizuar tri module trajnimi, përkatësisht:

Trajnim Bazë mbi Konceptet Gjinore, Trajnim i Avancuar mbi BPGJ dhe Bazat e Analizës Gjinore. Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga sektori i financave dhe koordinatorët për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat nga Agjencia për promovimin e zhvillimit të bujqësisë, Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Arkivi shtetëror i RMV, Agjencia për kadastër të pasurive të paluajtshme, Agjencia për shërbime mediatike audio audiovizive, Qendra për Menaxhimin e Krizave, Qendra për arsim dhe aftësim profesional, administrata për ekzekutimin e sanksioneve, Instituti për shëndet publik i RMV. Janë trajnuar gjithsej 40 persona. Një ashtu është duke u zhvilluar edhe një trajnim për trajnerë, në të cilin kanë marrë pjesë 20 përfaqësues nga institucionet dhe MPPS.

Në kuadër të objektivit strategjik 3-Lehtësimi, objektivi strategjik specifik 3.1-rregullimi normativ për parandalimin e dhunës me bazë gjinore: Miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Protokollin për bashkëpunim të ndërsjellë të subjekteve kompetente për marrjen e masave për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Në kuadër të qëllimit strategjik 4-Mbrojtja, objektivi strategjik specifik 4.1-mbrojtja e personave viktimë të trafikimit me qenie njerëzore, është realizuar trajnimi për punonjësit e shëndetësisë për identifikimin dhe referimin proaktiv të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Përsa i përket objektivit strategjik 4-Mbrojtja:

Objektivi specifik strategjik 1.1: Sigurimi i mbrojtjes dhe kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme: 1.1.1. Harmonizimi i legjislacionit vendas me standardet ndërkombëtare për viktimat e krimeve duke siguruar të drejtën e dëmit material dhe jomaterial nga një fond shtetëror. Komisioni për kompensimin monetar të viktimave të krimeve të dhunshme është në proces konstituimi.

Objektivi specifik strategjik 1.2:

Është analizuar dhe rishikuar kuadri ligjor i dispozitave që rregullojnë dhunën ndaj grave:

-1.2.1 Parandalimi i dhunës ndaj grave duke ofruar instrumente ligjore më efektive. Është duke u përgatitur Raporti vjetor për zbatimin e ligjit për ndihmën juridike falas për vitin 2022.

-1.2.2 Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi për zbatimin praktik të dispozitave të Konventës së Stambollit. Aktiviteti do të realizohet në gjysmën e dytë të vitit 2023.

Për sa i përket objektivit strategjik 5 - Komunikimi, edukimi dhe trajnimi:

-Objektivi strategjik specifik 1.1: Ngritja e nivelit të njohurive për zbatimin e Rezolutës 13/25:

1.1.1. Inkurajimi dhe shkëmbimi i përvojave për zbatimin e Rezolutës 13/25 në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar. Aktiviteti do të realizohet në gjysmën e dytë të vitit 2023.

QENDRTA PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE

Analizë e përfshirjes transparente në shoqëri, duke respektuar parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat

Qendra e Menaxhimit të Krizave ofron kushte për një mjedis transparent dhe të barabartë për gratë dhe burrat. Koordinator dhe zëvendëskoordinator i emëruar për mundësi të barabarta janë një burrë dhe një grua, ata koordinojnë në përgatitjen e analizave dhe raporteve për punën në situatë krize për të marrë pjesë në përgatitjen dhe ekzekutimin lidhur me parandalimin dhe trajtimin e situatës së krizës.

Përshtatja dhe rritja e kapaciteteve infrastrukturore të QMK-së sipas nevojave

Qendra e menaxhimit të krizave ka një infrastrukturë të personalizuar sipas nevojave të punonjësve. Janë miratuar dhe zbatuar planet për përshtatje gjinore infrastrukturore, si dhe janë siguruar burime të përhershme financiare për promovimin gjinor, gjegjësisht janë realizuar shumica e aktiviteteve ndërtimore - rindërtimi i objekteve në QMK.

Mbrojtja e grave dhe grupeve vulnerabël në RMV në QMK në mënyrë indirekte përmes SMK

Në Qendrën e menaxhimit të krizave, në bazë të kompetencave ligjore, parashikohen masa sigurie

edhe për gratë dhe kategoritë e tjera vulnerabël, veçanërisht në rast krizash dhe situatash krize. Njëkohësisht, në Sektorin e ri për thirrjet emergjente 112, i cili është përgjegjës për pranimin e thirrjeve për situata emergjente dhe koordinimin e tyre, është planifikuar që në çdo grup operatorësh për pranimin e thirrjeve të ketë të paktën një operatore femër, e cila është përgjegjës për marrjen e thirrjeve emergjente.

Rritja e rëndësisë së zbatimit të rezolutës 1325 të OKB-së - "Gratë, paqja dhe siguria"

Në trajnimin “Barazia Gjinore”, e cila u organizua nga MPPS, morën pjesë koordinatorja dhe zëvendëskoordinatori për barazi gjinore nga QMK, në trajnim u trajtuan temat e mëposhtme: Trajnim bazë për gjininë, barazinë gjinore dhe futjen e perspektivës gjinore në politikat publike.

Trajnimi u zhvillua nga data 06-07 mars 2023 në Qendrën Burimore për politikëbërje dhe buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

Dy përfaqësuese femra ishin pjesë e takimit “Koordinimi dhe Zbatimi i PNV-së së Dytë”, ku u diskutua për raportin vjetor dhe aktivitetet e mëtejshme.

Takimi u mbajt më 25 maj 2023 në qendrën trajnuese "Dr. Josef Kruzell", kazerma "Goce Dellçev", Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut.

I. PËRFUNDIM

Përveç institucioneve të përmendura më lart, palët e tjera të interesuara janë emëruar si institucione përgjegjëse për zbatimin e PNV-së së dytë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Rezolutën 1325 të Kombeve të Bashkuara "Gratë, paqja dhe siguria" (2020 - 2025) - kuadrin strategjik, nuk kanë dorëzuar raporte/briefinime gjashtëmujore për aktivitetet e realizuara në periudhën e specifikuar, megjithëse dinamika e raportimit është e përcaktuar në PNV-në e dytë, të rënë dakord shtesë në një takim koordinues në maj 2023, si dhe të kërkuara në mënyrë elektronike nga secili institucion.

KOORDINATORJA

e Grupit të Punës për koordinimin,
monitorimin dhe vlerësimin e PNV-së së

dytë

kolonel Antonela Stankovska-Budimir